




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE  
MUNICIPALITY OF GJILAN  
GILAN BELEDIYESI

## Njësia e Prokurimit

Gjiilan, me datë: 27.06.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjiilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të dt. **26.06.2023**, të parashtruar nga OE " **TALI** " **SH.P.K GJILAN** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: " **Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gadish** " me nr.të prokurimit **651-22-11628-5-2-1** dhe me nr.të brendshëm **GL 651 22 102 521** nxjerr:

### V E N D I M

1. **Refuzohet** - kërkesa për ri-shqyrtim e OE " **TALI** " **SH.P.K GJILAN**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: " **Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gadish** " me nr.të prokurimit **651-22-11628-5-2-1** dhe me nr.të brendshëm **GL 651 22 102 521** e dt. **26.06.2023** kundër *Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 23.06.2023* të publikuar në platformën e prokurimit elektronik.
2. **AK - Komuna e Gjiilanit Vazhdon sipas Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 23.06.2023.**
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

OE " **TALI** " **SH.P.K GJILAN**, me datë **26.06.2023**, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: " **Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gadish** " me nr.të prokurimit **651-22-11628-5-2-1** dhe me nr.të brendshëm **GL 651 22 102 521** .

Autoriteti Kontraktues me datë **27.06.2023** ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Sipas pretendimit tuaj: *Se jeni shpallur si operator i papergjegjshem për arsye të një gabimi aritmetikor. Gabimi ka qen i AK. Në këtë rast duhet të anulohet tenderi dhe të kthehet në ritenderim.*

*Se Lista e përshkrimit - pararnasa dhe parallogaia e derguar ng AK në Rekapitulim nuk është kalkuluar Krahu 3.*

**Përgjigjia e AK lidhur me këto pretendim është se:**

**Autoriteti Kontraktues ( AK ) - në harmoni me Nenin 59 të LPP-së, ka bërë ekzaminim, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave, dhe sipas kritereve të përcaktuara në FDT dhe Njoftimin për kontratë në harmoni me Nenin 60 Kriteret për Dhënie e Kontratës ka shpërblyer me kontratë publike operatorin ekonomik që ka dorëzuar: Tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.**

**Meqenëse kjo lëndë është kthyer në Rivlerësim sipas Vendimit të OSHP-së me nr. 49/23 të dt.07.06.2023, "citoj" Paneli shqyrtues anaizoj DT , më saktësisht pjesë për të cilën AK ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit me arsyetimin se ka gabime që nuk janë të evitueshme dhe konstaton se kjo pjesë i përbman të gjitha informatat relevante, të përshkruara në mënyrë të qartë dhe të saktë të lidhura me lëndën në fjalë, duke ju mundësuar OE të interesuar për të pasur njohuri të sakta për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Pasi që lënda është sipas Vendimit të OSHP-së me nr. kthyer në rivlerësim, AK ka vlerësuar gjitha ofertat, dhe ka vendosur sipas Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 01.03.2023.**

**Andaj, ashtu siç jeni të informuar edhe përmes Letrës standarte B42 për ofertën tuaj Komisioni për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve ka konstatuar se sipas procesverbalit të hapjes dhe formularit të dorëzimit të tenderëve çmimi i ofertuar është në vlerë prej 90,864.00 €, komisioni gjatë procesit të vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka bërë korigjimin i cili është në vlerë prej 100,977.50 € që do të thotë se korigjimi është për diferencën prej 10,113.50 €, nga çmimi i ofertuar sipas procesverbalit të hapjes.**

**Dallimi në përqindje është 10.01 %.**

**Bazuar në nenin 40 pika 40.9**

**b) Në rast se shuma e korigjuar është më shumë se +/- 2%, AK do të eliminojë OE dhe do të informoj me shkrim OE në fjale duke përdorur formën standarde B42.**

**Vlera e parashikuar për këtë aktivitet nga AK ka qenë: 100,000.00 €.**


Duke parë pretendimet tuaja Ankimore ne si AK kemi shqyrtuar në detaj këto të fundit.

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

**UD.Rrezelina Uka**



**Menaxhere e zyrës së Prokurimit**

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Te gjitha palëve të interesuara;  
Arkivit të Komunës.